

**UDHËZIM**  
**Nr.1547, datë 27.8.2009**

**PËR NIVELIN E KUOTAVE TË SHPENZIMEVE PËR USHQIME, NË  
INSTITUCIONET PUBLIKE REZIDENCIALE E KOMUNITARE TË PËRKUJDESIT  
SHOQËROR**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 24 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për klientët, që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror është:

- a) për fëmijët e vendosur në shtëpinë e foshnjës 0-3 vjeç 290 lekë;
- b) për fëmijët e vendosur në shtëpinë e fëmijës 3-6 vjeç 300 lekë;
- c) për fëmijët e vendosur në shtëpinë e fëmijës 6-15 vjeç 320 lekë;
- d) për personat e vendosur në qendrat e zhvillimit 330 lekë;
- e) për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve 280 lekë;
- f) për klientë në qendrat pritëse, rehabilituese dhe riintegruese për viktimat e trafikimit sipas kategorive të përfituesve të përcaktuara në gerrat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e” të këtij udhëzimi.

2. Niveli i kotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për klientët, që përfitojnë shërbime në qendra ditore publike të përkujdesit shoqëror është:

- a) në qendra ditore polivalente 150 lekë,
- b) në qendrat ditore të zhvillimit 210 lekë,
- c) në shtëpinë e foshnjës 0-3 vjeç 200 lekë.

3. Niveli i kuotës për shpenzimet ditore ushqimore për kuzhinierët dhe ndihmëskuzhinierët, që punojnë në këto institucione, është i barabartë me 60% të kuotës financiare ditore për ushqim, për kategoritë e përfituesve të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij udhëzimi.

4. Efektet financiare nga rritja e nivelit të kuotës financiare të shpenzimeve për ushqim, përballohen nga fondet e buxhetit qendror, të programuara për shërbimet e përkujdesit shoqëror për vitin 2010.

5. Udhëzimi nr.303, datë 13.2.2007 “Për nivelin e kotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi më 1.1.2010.

**MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE  
SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA  
Viktor Gumi**